



BALLINA

LAJME

VIDEO

BOTA

SPORT

OPINION

SHOWBIZ

LIFESTYLE

AUTO & TEK

FUN

ENGLISH

Gjashtë të arrestuar për rrahje në Prishtinë, konfiskohet edhe një armë



LAJME

03/07/2023 11:18



Policia e Kosovës ka njoftuar se i ka arrestuar gjashtë persona nga policët civilë në Prishtinë.

6 të dyshuarit janë arrestuar pasi policia kishte marrë informatën se në një parking në një veturë ka një armë, kurse policia kishte hasur në një rrahje.

Sipas policisë intervenimi ka ndodhur menjëherë pas marrjes së informatës, me ç’rast janë arrestuar të njëjtit.

Ndërsa pronarit të automjetit i është konfiskuar edhe një thikë dhe një fishek. Me urdhër të prokurorit 6 të dyshuarit janë dërguar në mbajtje ndërsa dy të tjerë janë liruar në procedurë të rregullt.

Njoftimi i plotë:

Policia e Kosovës, në vazhden e shtimit të aktiviteteve operative në terren, si rezultat i angazhimit të zyrtarëve policorë edhe në rroba civile, me qëllim të identifikimit të kriminalitetit dhe dukurive të tjera negative, ka pranuar informacione se në një lokacion gjendej një veturë në të cilën dyshohet se ndodhej një armë zjarri.

Me datën 03.07.2023, njësitë policore si rezultat i implementimit të një plani operativ në terren, kanë arritur të sigurojnë informacione se në një parking në Prishtinë gjendet një veturë e dyshuar në të cilën ndodhet një armë zjarri, me ç’rast zyrtarët policorë kanë reaguar menjëherë duke shkuar në vendin e ngjarjes, ku si rezultat në të njëjtin lokacion kanë hasur në një rrahje mes disa personash.

Lidhur me rastin janë thirrur në asistencë edhe njësi të tjera për intervenim, ku si rezultat janë shoqëruar në stacion policor gjithsej 6 (gjashtë) persona të dyshuar, të cilët më pas janë intervistuar. Po ashtu është bërë edhe kontrolli i veturës së dyshuar, me ç’rast është gjetur dhe është konfiskuar një armë zjarri, si dhe gjatë kontrollit tek i dyshuari mashkull kosovar pronar i automjetit të lartcekur, është gjetur dhe është konfiskuar një thikë dhe një fishek.

Në lidhje me rastin është konsultuar prokurori kompetent ku ndaj personave të dyshuar të lartcekur janë iniciuar rastet ‘lëndim i rëndë trupor’ dhe ‘mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve’, ku 4 (katër) nga 6 (gjashtë) të dyshuarit janë dërguar në mbajtje, ndërsa 2 (dy) të tjerë janë liruar në procedurë të rregullt.

Artikuj të ngjashëm



July 3, 2023

Gjykata e Apelit merr vendim për “Burdushin”



July 3, 2023

Kosova nën sanksione, Kurti flet me Borrellin në telefon: Thotë se...



July 3, 2023

Policia kërkon ndihmë nga qytetarët për identifikimin dhe kapjen e një...



July 3, 2023

Tensionet në veri: Lajçak këtë javë në Kosovë dhe Serbi



July 3, 2023

Publikohen rezultatet e provimit të maturës, Nagavci mburret: Këtë vit menaxhimi...



July 3, 2023

I “forti” dhe filozofi i VV’së i qepon pak LDK-së: Thotë...

lajmi.net

info@lajmi.net

Tel: +383 49 131 131

Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrra nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy

Ethics Policy

Corrections Policy

Ownership & Funding Information

Editorial Team Information